

Në bazë të nenit 55 paragrafi 1 të Ligjit për organizim dhe punë të organeve të administratës shtetërore („Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 58/00, 44/02, 82/08, 167/10 dhe 51/11 dhe “Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut 96/19 dhe 110/19) dhe neni 22 dhe 25 të Ligjit për arsim të mesëm („Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 44/1995, 24/1996, 34/1996, 35/1997, 82/1999, 29/2002, 40/2003, 42/2003, 67/2004, 55/2005, 113/2005, 35/2006, 30/2007, 49/2007, 81/2008, 92/2008, 33/2010, 116/2010, 156/2010, 18/2011, 42/2011, 51/2011, 6/2012, 100/2012, 24/2013, 41/2014, 116/2014, 135/2014, 10/2015, 98/2015, 145/2015, 30/2016, 127/2016, 67/2017 и 64/18) ministri i Arsimit dhe Shkencës përcaktoi programin e shkurtuar mësimor nga lënda e Informatikës për vitin I në arsimin e mesëm profesional katërvjeçarë për vitin shkollor 2020/21.

## 1. Hyrje

Programi i shkurtuar mësimor në lëndën mësimore të Informatikës bazohet në rezultatet e mësimnxënies të parapara me programin mësimor për lëndën mësimore që rregullisht realizohet në pajtim me planin e caktuar mësimor. Me programin e shkurtuar përcaktohen temat e caktuara dhe njësitë mësimore që duhet realizuar për 159 ditë mësimore, me çka ruhet fondi i paraparë i orëve i caktuara në programin e rregullt, përkatësisht për lëndën mësimore me 2 orë në javë parashihen 64 orë në vitin shkollor 2020/21. Mësimdhënësi gjatë planifikimit dhe realizimit të njësive mësimore nga programi i shkurtuar udhëhiqet nga rezultatet e mësimnxënies, përbajtjet, nacionet e caktuara, metodat dhe aktivitetet e përcaktuara në programin e rregullt mësimor.

## 2. Pasqyra e njësive modulare dhe përbajtjet

Nr. rendor	Njësia modulare	Përbajtjet
1.	HARDUERI (6 orë)	<p>Ndarja e kompjuterëve bashkëkohor, Desktop, Server, Statik dhe kompjuter bartës.</p> <p>Kompjuteri personal (nacioni)</p> <p>Sistemi kompjuterik (harduer dhe softuer)</p> <p>Modeli bashkëkohor i kompjuterit personal</p> <p>Funksionaliteti i karakteristikave të komponentëve të harduerit, kompjuteri personal</p> <p>Procesori, memoria, bit, bajt, njësia qendrore, njësitë hyrëse, njësitë hyrëse, njësitë hyrëse – dalëse, pllaka amë (nacionet)</p> <p>Ergonomia dhe pjesët ergonomike të harduerit, tastiera ergonomike, pajisjet tjera ergonomike</p>
2.	SOFTUERI (5 orë)	<p>Softueri: sistematik dhe aplikativ</p> <p>Sistemi operativ: roli, struktura</p> <p>Nacioni për dadotekën. Sistemi i dadotekave, Dadoteka dhe direktori (dosja)</p>

		Arkivimi dhe kompresimi i dadotekave Softueri i rrezikshëm dhe mbrojtja nga ai, Virusi kompjuterik, Trojanec, Spam porositë, Programi antivirus Nocioni për softuerin e lirë, versioni provues, softueri i licencuar.
3.	PROGRAMI PËR PËRPUNIMIN E TEKSTIT (7 orë)	Formatimi i dokumentit Formatimi i objekteve grafike në tekst Puna me stile Përbajtja dhe indeksi Shablloni dhe formulari Mbrojtja e dokumenteve
4.	NOCIONI PËR ALGORITËM DHE PROGRAME (2 orë)	Algoritmi dhe prezantimi i tij Nocioni për programin si pjesë e softuerit dhe roli i programeve në kompjuter
4.1.	PROGRAMIM, GJUHËT PROGRAMORE DHE MJEDISET E INTEGRUARA PËR PROGRAMIM (6 orë)	Programimi dhe gjuhët programore Procesi i përpunimit të një programi (nga versioni burimor deri te versioni përfundimtar) Njohja me elementet themelore të mjedisit të integruar për programim Pamja e shembujve të gatshëm të kodeve programore Kryerje e shembujve të gatshëm të programeve dhe dadotekave të cilat riprodhohen Debagim
4.2.	PROGRAMI ME STRUKTURË VIJUESE (6 orë)	Elementet themelore të gjuhës programore (GJP) (alfabeti i gjuhës, pjesët ndërtimore, komentet, madhësitë, identifikuesit, shprehjet, fjalët kryesore, nënprogramet) Të dhënat. E dhëna për shfaqje në ekran Teknika e kryerjes në kontinuitet
4.3.	VARIABLET DHE TË	Operacionet aritmetike dhe shprehjet

	DHËNAT SHPËRNDARJE (4 orë)	PËR	Madhësitë në GJP. Konstantat dhe ndryshimet Ndarja e vlerave të variabëlve. Operatori i shpërndarjes Lloji i variabëlve
4.4.	STRUKTURA ZGJEDHJEN E MUNDËSIVE (6 ORË)	PËR DY	Shprehjet krahasuese Shprehjet logjike Struktura (e dhënë) për zgjedhjen e dy mundësive Blloku i shprehjeve (urdhrave) Përpunimi i programeve
5.	PROGRAMI PËRLLOGARITJE TABELAR E (12)		Formatimi i tabelës dhe elementet nga tabela (qeliza, rreshti, kolona) Përdorimi i avancuar i formulave dhe funksioneve Puna e avancuar e grafikoneve Filtrimi dhe klasifikimi i të dhënavë
6.	RRJETËT KOMPJUTERIKE DHE INTERNETI (10)		Hyrje: Çka është rrjeti kompjuterik? Karakteristikat e rrjetit kompjuterik; Hyrje në stacionet e punës. Rrjetëzimi në desktop dhe në kompjuterët bartës, Pajisjet periferike dhe pajisja shtuese në rrjet: tastiera, miu, monitori, printer; Hyrje në distribuominin e rrjetit. Rrjet i kabllove. Hyrje në distribuonim e rrjeteve. Hab. Udhëzues (ruterë) Rrjet kartelash; Internet Servis Provajder (ISP); (firewall). WWW – teknologjité e tanishme dhe teknologjítë të cilat vijnë: Rikujtim për Hyper Text Transfer Protocol (HTTP) Lokator të unifikuar të resurseve (Uniform Resource Locators – URLs) Veb Rrjete sociale dhe pyetje për privatësinë e të dhënavë personal

## **2. Rekomandime didaktike**

- Rezultatet nga mësimi në programin mësimor mund të realizohen me paket programor sipas zgjedhjes së mësimdhënësit ose me paket programor që është në disponim të kabineteve të pajisura me kompjuter
- Udhëzime për lidhje ndërmjet lëndëve (planifikimi i integruar, kryesisht ndërlidhja e qëllimshme dhe përmbajtësore ndërmjet lëndëve dhe fushave të ngashme):
- gjuha amtare (sintaksa, semantika dhe gramatika);
- matematika (numra të plotë, numra real, sistemi koordinues, trupa gjeometrik, formula, funksione dhe puna me lloje të ndryshme të të dhënave);
- gjuha e huaj (shqiptimi dhe shkruarja e fjalëve dhe nocioneve, mënyra e përpunimit të tekstit);
- arsimi figurativ (kuptimi kreativ dhe vizual te disa detyra);
- të gjithë lëndët tjera përmbajtjet e të cilave paraqesin përmbajtje në përpunimin e detyrave projektuese.

Për secilën njësi modulare të paraparë është propozuar fond i caktuar i orëve. Nga fondi i përgjithshëm i orëve të parapara në njësitë modulare janë lejuar mënjanime të vogla në pajtim me njohurit e nxënësve, përgatitja paraprake e nxënësve për punën me kompjuter, pajisje plotësuese me të cilën disponon shkolla dhe ngashëm. Në këtë kontekst disa përmbajtje do të përsëriten disa here në llogari të tjerëve të cilat do të punohen me fond më të vogël të orëve.

## **VLERËSIMI I TË ARRITURAVE TË NXËNËSËVE**

Gjatë mësimit të informatikës rekomandohet përcjellje formative që përfshin përpunimin dhe udhëheqjen e portfolies së nxënësve që përfshin:

- mbledhjen e treguesve (përpunimet e nxënësve në kompjuter) për secilin nxënës në veçanti;

- lista evoluese vijuese ( formative) të përgatitura paraprakisht për secilin nxënës në veçanti të cilat përpunohen sipas aktivitetit konkret të tij.

Në fund të seilit tremujorësh, në bazë të njohurive nga vlerësimi formativ realizohet vlerësimi mikrosumativ. Sipas natyrës së programit në lëndën e informatikës mësimi mund të realizohet gojarisht, praktikisht, me prezantime ngjashëm. Nxënësi vlerësohet me vlerësim numerik.

#### 4. Normativi për kuadrin mësimor

Programin e shkurtuar mësimor e realizon mësimdhënësi në pajtim me normativin për kuadrin mësimor të dhënë në programin e rregullt mësimor.

Programin e shkurtuar mësimor nga lënda mësimore *Informatika për vitin I* në arsimin e mesëm profesional katërvjeçarë, me propozimin e Byrosë së zhvillimit të arsimit e përcaktoi

Ministër i Arsimit dhe Shkencës

---

Milla Carovska